

## **REKOMANDIM PËR PUBLIKIMIN E INFORMACIONEVE ME KARAKTER PUBLIK TË KËRKUAR/OFRUAR TASHMË NË UEB FAQET E POSEDUESVE TË INFORMACIONIT**

Konsiderohet praktikë e mirë kur poseduesit e informacionit, duke publikuar ueb faqet e tyre, i vënë në dispozicion të gjithë qytetarëve informacionin e kërkuar prej tyre, në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik.

Në këtë mënyrë u lehtësohet qytetarëve qasja në informacione publike, sepse ata mund të marrin informacionin e kërkuar në mënyrë më të shpejtë dhe më ekonomike me më pak kohë të humbur dhe më pak burime financiare.

Gjithashtu, me këtë metodë të informacionit tashmë të publikuar, të kërkuar/dhënë, pritet të zvogëlohet numri i kërkesave për qasje të lirë, e me këtë edhe detyrimi i poseduesve të informacionit që të veprojnë për të njëjtat.